



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**AUTORITETI I KONKURENCËS**  
**DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE**

**NJOFTIM**

**Rasti:** Përftimi i kontrollit të shoqërisë Riofarma SHPK nga shoqëria TRIMED SHPK.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr.632 prot., i AK, datë 26.10.2022, “Njoftim i thjeshtuar i përfimit të kontrollit të shoqërisë Riofarma SHPK nga shoqëria Trimed SHPK”, ku jemi njoftuar lidhur me transaksionin mbi blerjen e të gjithë kuotave që përfaqësojnë kapitalin e shoqërisë Riofarma SHPK nga shoqëria TRIMED SHPK.

Referuar dokumentit “Kontratë për transferim kuotash”, palët në marrëveshje janë:

***Pala blerëse:*** TRIMED SHPK, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit shqiptar me objekt veprimtarie; import-eksport tranzit, depo farmaceutike, përfaqësim në fushat farmaceutike, prodhim-përpunim-konfeksion; import-eksport-tranzitim-tregtim me shumicë e pakicë të medikamenteve, materialeve mjekësore e aksesorëve të tyre, barnave, materialeve dentare e veterinare, higjenosanitare, barnave mjekësore popullore, artikujve të ndryshëm kozmetike e produkteve të parukerisë & estetikës, solucioneve injektabel të lëngjeve të distiluara dhe të gazuara, avulli & akulli, produkteve me origjinë bimore e shtazore, etj.; pajisje laboratorike, marketing dhe promocion; import-eksport-tranzitim-tregtim me shumicë dhe pakicë të pajisjeve mjekësore, pajisjeve dhe instrumenteve ortopedike, protezave të artikulacioneve dhe impianteve dentare.

***Pala shitëse:*** Edmond Hido është person fizik, shtetas shqiptar, i cili zotëron 100% të kuotave të Riofarma SHPK.

**Shoqëria Target:** Riofarma SHPK, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit shqiptar me objekt të veprimtarisë; Tregtim me shumicë dhe prodhim i medikamenteve farmaceutike, import-eksport i tyre, pajisje, instrumente medicinale, sanitare, ushqime dietike për fëmijë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**